

SHTËPIA JONË



KUPTIMI I FJALËS DEMOKRACI

OLISA (12), BEKIM (12), VLERA (12), DION (13), RIDIN (12), GRAMOS (12)



Demokracia atëherë dhe sot

Të jetosh në një shtet demokratik do të thotë të kesh të drejtën e të shprehurit lirshëm.

Demokracia ka lindur në vitin 507 para erës sonë në Athinë, Greqi. Në vitet e para të themelimit të demokracisë, gratë nuk kanë pasur të drejtën e çasjes në zgjedhje. Demokracia në kohët e sotme nga kohët e mëparshme ka ndryshuar mjaft shumë. Sot, si burrat edhe gratë e kanë të drejtën e votimit dhe pjesëmarrjes në zgjedhje.

Fjala demokraci rrjedh nga fjala greke „demos“ që do të thotë *popull* dhe „kratia“ që do të thotë *udhëheqje*. Demokracia ndahet në dy lloje: demokracia e drejtpërdrejtë dhe demokracia përfaqësuese. Demokracia përfaqësuese ndahet në: sistemin parlamentar dhe sistemin presidencial.

Demokracia e drejtpërdrejtë, është kur populli në mënyrë direkte zgjedh se si do të funksionoj shteti i tij, ndërsa demokracia përfaqësuese është kur populli zgjedh përfaqësuesit e tij. Elementet kryesore të demokracisë janë: liria, paqja, barazia, toleranca, të drejtat e barabarta, etj.

Fjala liri do të thotë të jesh i lirë dhe i pavarur. Të jetosh në paqe do të thotë të kemi tolerancë ndaj njëri -tjetrit. Përveç tolerancës, element tjetër mjaft i rëndësishëm i demokracisë janë të drejtat e barabarta, pa marrë parasysh nënshtetësinë, racën, gjininë, fenë etj.

Ne jetojmë në një shtet demokratik, prandaj kemi

shumë të drejta. Të drejtat tona janë: shkollimi, strehimi, identiteti, loja, edukimi, etj. Ne si fëmijë kemi të drejtën e shkollimit të gjithë të barabartë, dhe si ne e kanë edhe moshatarët tanë me aftësi të veçanta. Kjo është shumë e rëndësishme, pasi që jetojmë në një shtet demokratik, dhe kemi të drejtat e barabarta.



Gazetarët e artikullit

VOTIMI I QYTETARIT

DORUNTINA (12), JETA (12), RIJAD (12), LEART (12), JETLIR (12), REDON (12)

Të mësojmë për demokracinë, zgjedhjet, kuvendin, dhe aristokracinë në Greqi.

Fjala demokraci rrjedh nga gjuha greke që në shqip do të thotë udhëheqje e popullit.

Qytetarët votojnë dhe me votat e tyre zgjedhin deputetët. Qytetarët mund të votojnë nga mosha 18 vjeçare. Dallojmë dy lloje të zgjedhjeve, kemi zgjedhje lokale dhe qendrore. Zgjedhjet lokale janë zgjedhje në të cilat zgjedhet kryetari i komunës, ndërsa në zgjedhjet qendrore zgjedhim deputetët, të cilët do të na përfaqësojnë ne.

Populli udhëheq në shtetin tonë!

Në kohët e hershme, të drejtë për të votuar kishin vetëm burrat e pasur, pastaj të drejtë kishin të gjithë burrat e më vonë edhe gratë. Ne kemi biseduar edhe rreth një pyetje, „Cili është obligimi apo detyrimi ynë si qytetar?“

Si përfundim, obligimi ynë si qytetar është votimi dhe respektimi i rregullave pra, që të mos e thyejmë ligjin.



Grupi ynë sot



Ilustrim që tregon obligimin tonë qytetar



Duke shkruar artikullin



Ne ndihemi të rëndësishëm në vendin tonë

Vota është e rëndësishme




Jetliri duke mbajtur vizatimin e tij

Cilat janë detyrat e Qeverisë dhe të Gjykatave në Kosovë?


Biseda jonë vazhdoi me diskutimin rreth Qeverisë dhe Gjykatës. Qeveria është institucion ekzekutiv, dhe përbën degën ekzekutive, një degë shumë e rëndësishme në një shtet demokratik. Por, pse është kaq e rëndësishme? Sepse detyra e Qeverisë është ekzekutimi i ligjeve të miratuara nga Kuvendi. Atë e përbëjnë kryeministri dhe ministrat e ndryshëm, si p.sh. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Qeveria formohet në Kuvend, prej partisë pozitive e cila ka fituar shumicën e votave të qytetarëve.

Gjykata është institucion i lartë gjyqësor, e cila gjykon të pandehurit dhe qytetarët të cilët shkelin ligjet. Në Kosovë, kemi tri lloje të gjykatave: themelore, e apelit, dhe supreme. Kjo punë duhet të bëhet me seriozitet. Ne mendojmë se pushteti duhet të ndahet në mënyrë që punët dhe përgjegjësitë të jenë më të lehta. Kjo, sipas nesh, e mundëson zhvillimin e demokracisë dhe shtetit tonë.



Trungu i mendimeve tona

Sa e mirë demokracia!




Ndarja e pushtetit sipas nesh



Ne duke punuar për zhvillimin e demokracisë sonë



Grupi ynë



„Jo thjesht një gjeth!“

NE JEMI QYTETARË AKTIV

LEON (13), OLTIS (12), FJOLLA (12), GLAUK (12), DIJAR (13)

Ne si qytetarë kemi të drejta dhe përgjegjësi, e cilat janë ato mësojeni më poshtë në artikullin tonë

Qytetar konsiderohet ai person i cili është pjesë e një shteti dhe ka të drejta të barabarta në atë vend. Të gjithë ne jemi qytetarë të Kosovës dhe kemi të drejta, por edhe përgjegjësi.

Disa nga të drejtat tona si qytetarë janë: lëvizja e lirë, barazia gjinore, e drejta e votës, shprehja e mendimit, etj. Mirëpo, përgjegjësi e jona është: të respektojmë ligjin, të ruajmë ambientin, të pastrojmë atë, të mësojmë, të mos diskriminojmë, të respektojmë njëri-tjetrin, etj.

Ne sot mësuam se jemi shumë të rëndësishëm në demokraci si qytetarë. Prandaj, kur të rritemi do të jemi qytetarë aktiv duke marrë pjesë në zgjedhje, protesta paqësore, në shoqata, etj.



Të lumtur e shkruam artikullin



Vetëm duke punuar mund të jemi qytetarë aktiv



Përgjegjësi e jona është edhe ta ruajmë ambientin



Vetëm duke mësuar mund ta ndihmoj vendin tim



Pavarësisht racës, ne duhet të jemi të barabartë



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Nazim Gafurri“
Klasa: VII-2
Vendi: Prishtinë